



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT**

RELACION

**PËR SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.
81 DATË 29.12.2020 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR
VITIN 2021 DHE PBA 2021-2023"**

Të nderuar këshilltarë!

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 29.12.2020 u diskutua gjerësisht rreth Relacionit "Projekt Buxheti i vitit 2021 dhe PBA 2021-2023" të Bashkisë Berat.

Materiali i ndërtuar në sistemin raportues të të ardhurave dhe shpenzimeve dha informacion mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas strukturave buxhetore, sipas njësive shpenzuese, mbështetur në realizimin faktik të dy viteve të mëparshme (2018,2019) dhe në pritshmërinë e realizimit të tyre deri në fund të vitit 2020.

Në këtë material po paraqesim në mënyrë të përmbledhur treguesit faktikë të realizimit të buxhetit pas rakordimit përfundimtar me degën e thesarit. (analitikisht realizimi i buxhetit pasqyrohet në Raportin e Monitorimit të buxhetit të vitit 2020, të cilin do e sjellim tek ju në mbledhjen e radhës brenda këtij muaji).

Bashkia Berat miratoi buxhetin e vitit 2020 me VKB nr. 66 date 26.12.2019 dhe u konfirmua nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 1580/4 prot. datë 13.01.2020, i cili më pas u dërgua për celje pranë degës së thesarit brenda afatit ligjor .

Në mbështetje të ligjit "Për buxhetin e vitit 2020", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit", Bashkia Berat miratoi këta tregues të buxhetit fillestar:

në 000 / lekë

A - Të ardhurat gjithsej (I +II).....	1,075,270
I - Të ardhurat e buxhetit të pavarur.....	528,209
• Të ardhurat lokale, Plan i vitit 2020.....	528,209
II - Transferta gjithsej.....	547,061
• Transferta e pakushtëzuar.....	293,099
• Transferta specifike	253,962
B - Shpenzimet gjithsej	1,075,270
• Shpenzime operative.....	901,816
• Shpenzime kapitale.....	173,454

Me VKB nr. 14 datë 27.02.2020 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr 189/1 prot. datë 03.03.2020, u miratua shtesa e buxhetit të bashkisë për të ardhurat e trashëguara nga viti 2019 në vitin 2020, buxhet i cili u bë efektiv pranë Degës së Thesarit Berat.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

U shtua buxheti i bashkisë me të ardhurat e trashëguara në shumën **58,316,663 leke**, nga të cilat : të ardhura vendore 21,928,880 lekë, + transferta e pakushtëzuar e trashëguar në shumën 5,905,411 lekë + transferta specifike në shumën 30,482,372 leke.
Gjatë procesit të zbatimit të buxhetit, pas ndryshimeve të bëra si dhe vendimeve të marra në Këshillin Bashkiak, Bashkia Berat në fund të vitit 2020 rezulton me këtë situatë financiare në 000/ lekë:

I. TOTALI I FINANCIMEVE (TË HYRAT) në 000 Lekë : 937,406 në 000/lekë

1. Fonde nga Transferta e pakushtëzuar e v. 2020.....	290,474
2. Fonde nga Transferta për funksionet specifike e v.2020.....	253,727
3. Fonde nga Të ardhurat e vitit (Realizimi i planit të të ardhurave v. 2020.....	297,831
4. Fonde Të trashëguara nga vitit 2019 në vitin 2020	58,317
• të ardhura lokale	21,929
• transfertë e pakushtëzuar	5,906
• transfertë specifike	30,482
TOTALI I FINANCIMEVE (TË HYRAT).....	937,406

II. TOTALI I SHPENZIMEVE (TË DALAT) në 000 Lekë : 816,588

Drejtoria e Financës e Bashkisë Berat pas mbylljes së vitit buxhetor 2020, kreu rakordimet përfundimtare me degën e Thesarit për gjithë të ardhurat e arkëtuara për llogari të bashkisë Berat për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020 si dhe për shpenzimet e likujduara deri më 31.12.2020.

Shpenzimet faktike të Bashkisë Berat për vitin 2020 janë si më poshtë :

1. Shpenzime për personelin (paga dhe sigurime).....	465,890
2. Shpenzime operative & të mirëmbajtjes dhe të tjera.....	261,410
3. Totali i shpenzimeve korrente.....	727,300
4. Shpenzime për investime	89,288
TOTALI I SHPENZIMEVE 2020.....	816,588

III. FONDE TË PAPËRDORURA TË TRASHËGUARA NGA VITI 2020 NË VITIN 2021 në 000 Lekë : 120,819

Sipas akt-rakordimit të mbajtur me degën e thesarit shuma e të ardhurës që trashëgohet në vitin 2021 është **121,818,808 lekë**, e cila përbëhet nga fondet e papërdorura si më poshtë :

1. Transferta e pakushtëzuar sektoriale specifike	47,244,788 Lekë
2. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme.....	27,742,343 Lekë
3. Të ardhurat lokale	45,831,677 Lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Gjithashtu bashkia Berat trashëgon nga viti 2020 të ardhura jashtë limitit (sponsorizime) në shumën 2,385,449 Lekë të cilat janë me destinacion të përcaktuar në kontratën e sponsorizimit dhe celen në destinacionin përkatës .

Emertimi i Projektit te Sponsorizuar	Sponsorizuesi	Njesia Shpenzuese	Trashëg nga viti 2019	Derdhur ne vitin 2020	Shuma Totale	Përdorur ne vitin 2020	Mbeten per tu trashëg. 2021
Sponsorizime 7207011							
Dekori i qytetit	TAP	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	618,500		618,500		618,500
Sigurimi publik ne nivel vendor	FLAG	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	637,520	130,480	768,000	510,000	258,000
Rikonstruksioni i Shatërvanit	Alpha Bank	Bashkia Berat (Aparati)	205,000		205,000		205,000
Erasmus +	Bashkia Europian	Bashkia Berat (Aparati)	57,811		57,811		57,811
Sponsorizim per Bibloteken e qytetit		Bashkia Berat (Aparati)	20,133		20,133		20,133
Sponsorizim per Q. "Lira"		Qendra LIRA	1,750		1,750		1,750
Dezinsektante per institucionet e arsimit	FLAG	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat		205,136	205,136	204,880	256
Blere mjeti tip Funçon per Qendren " Lira"	ASED	Qendra LIRA		1,224,000	1,224,000		1,224,000
Shuma Sponsorizime			10,788,213	1,559,616	12,347,829	9,962,380	2,385,449

Bashkia Berat në mbyllje të vitit buxhetor 2020 rezulton të ketë detyrime të prapambetura në shumën 143,347.084 Lekë. (sipas përcaktimeve ligjore përfshihen faturat e palikujduara pas afatit mbi 60 ditë nga data e lëshimit/lindjes së detyrimit).

Rreth 58 % e stokut të detyrimeve përfaqësohet nga investimet, 35 % nga detyrimet për mallra & shërbime dhe 7 % nga vendime gjyqësore.

Detyrimet e prapambetura ne dt. 31.12.2020 (llog 4864)

Nr	Njesia Shpenzuese	Total detyrime te prapambetura 31.12.2020	Vendime Gjyqësore llog 4864100	Shërbime llog 4864200	Mallra llog 4864600	Te tjera llog 4864900	Investime llog 4864400
1	Bashkia Berat (Aparati)	113,627,868	9,724,648	19,121,518	707,172	1,126,056	82,948,474
2	Ndërmarrja e Gjellbërimit	0	0	0	0	0	0
3	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	16,486,540	0	0	4,751,904	11,734,636	0
4	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	12,632,676	0	3,537,862	0	9,094,814	0
5	Qendra Kulturore " M. Tutulani "	600,000	0	0	0	600,000	0
6	Qendra LIRA	0	0	0	0	0	0
7	Drejtoria e Bujqësisë	0	0	0	0	0	0
total		143,347,084	9,724,648	22,659,380	5,459,076	22,555,506	82,948,474
		100%	6.8%	15.8%	3.8%	15.7%	57.9%

Në buxhetin e vitit 2020 ishin parashikuar për t'u likujduar edhe faturat për shpenzimet e kryera në muajt Nëntor & Dhjetor 2020. Për arsye të kufizimit të pagesave, një pjesë e faturave të muajve në fjalë nuk u likujduan, duke krijuar fonde të papërdorura nga ana tjetër. Vlera e detyrimeve për faturat e m. 11/20 & 12/20 është 34,444,477 Lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Detyrimet për faturat e palikujduara të muajve nëntor & dhjetor 2020

Nr	Njësia Shpenzuese	total fatura m. 11/20 & 12/20	11 / 20	12 / 20
1	Bashkia Berat (Aparati)	26,692,223	15,932,178	10,760,045
2	Ndërmarrja e Gjelbërimit	0	0	0
3	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	4,757,555	1,462,367	3,295,188
4	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	2,994,699	1,610,620	1,384,079
5	Qendra Kulturore " M. Tutulani "	0	0	0
6	Qendra LIRA	0	0	0
7	Drejtoria e Bujqësisë	0	0	0
total fatura te palikujduara m. 11/20 & 12/20		34,444,477	19,005,165	15,439,312

PASQYRË PËRMBLEDHËSE E REALIZIMIT TË BUXHETIT 2020

Në 000/ lekë

Përshkrimi	Buxheti fillestar 2020	Buxheti i rishikuar 2020	Realizimi faktik 2020	në %
Totali i të ardhurave	1,075,270	1,134,803	962,625	82
Total Transferta	547,061	583,448	583,448	100
Transferta e pakushtëzuar	293,099	293,099	293,099	100
Transf. e pakushtëzuar trashëguar nga viti paraardhës	0	5,905	5,905	100
Transferta Specifike	253,962	253,962	253,962	100
Transf. e Specifike trashëguar nga viti paraardhës	0	30,482	30,482	100
Total të ardhura të veta	528,209	551,355	319,732	61
Të ardhura të veta	528,209	529,426	297,831	56
Të ardhura të veta trashëguar nga viti paraardhës	0	21,929	21,901	100
Totali i Shpenzimeve	1,075,270	1,134,804	816,588	72
Total shpenzime operative (korrente)	901,816	960,132	727,300	76
Shpenzime personeli	514,286	513,936	465,890	91
Shp.operative, & mirëmbajtjes& të tjera transf.	387,530	446,196	261,410	59
Shpenzime kapitale	173,454	174,671	89,288	51



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Sipas Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 28, pika 5, fondet e papërdorura të transfertës specifike në fund të vitit buxhetor, trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës në të njëjtën funksion për të cilin janë dhënë në vitin e mbyllur buxhetor.

Transferta specifike në fund të vitit 2020 ka mbetur në programet dhe me shumatat përkatëse:

Në mijë lekë

Nr.	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Plani	Fakti	Mbetja
1	3280	Mbrojtja nga zjarri MZSH	36,206	30,054	6,152
2	4240	Ujitja dhe Kullimi	16,934	14,429	2,506
3	4260	Administrimi i pyjeve	5,222	4,496	727
4	4520	Rruget rurale	4,824	4,824	0
5	9120	Arsimi parashkollor dhe ai baze	134,538	134,538	0
6	9230	Arsimi parauniversitar	13,817	13,048	769
7	9240	Konviktet e arsimit parauniversitar	46,308	12,111	34,197
8	10140	Qendra Lira	26,595	23,700	2,895
Totali			284,444	237,200	47,245

Në këtë situatë, propozojmë që fondet e papërdorura të trashëguara nga viti 2020, të alokohen si më poshtë:

Alokimi i fondeve të trashëguara për shpenzime të ndara sipas natyrës ekonomike:

1.Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore (llog 600&601) : 8.100.000 Lekë,

Nga të cilat transfertë specifike 1,966,000 Lekë dhe të ardhura të veta (transf. e pakushtëzuar+të ardhura vendore) 6,134,000 Lekë.

Fondi shtohet në buxhetin e vitit 2021 të Njesisë Shpenzuese Drejtoria Arsimore Bashkia Berat, për pagesën e 16 punonjësve të shtuar në strukturën e kësaj njësie, me VKB nr 4 datë 28.01.2021, në funksion të ofrimit të shërbimit të gatimit dhe servirjes së ushqimit në cerdhe,kopshte e konvikte, nga ana e vetë Bashkisë me kapacitetet e saj.

Fondi i nevojshëm për paga dhe kontribute është llogaritur për 10 muaj, (periudhë e parashikuar për ofrimin e shërbimit nga e Bashkisë, pas mbarimit të afatit të kontratës me operatorin ekonomik Shpresa shpk), për 16 punonjës: 1 përgjegjës, 3 kuzhinierë, 10 ndihmës kuzhinierë (2 në kuzhinë dhe 8 të shpërndarë nëpër kopshte e cerdhe), një magazinier, një shofer automjeti, në secilin prej 3 programeve:

Titulli i Progr.	Emërtimi i Programit	Totali	Paga 600	Sigurime 601
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	3,713,000	3,186,000	527,000
09240	Konviktet e arsimit parauniversitar	1,966,000	1,687,000	279,000
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	2,421,000	2,077,000	344,000
Total		8,100,000	6,950,000	1,150,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Programi 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor : 7 punonjës

Emërtimi	Nr Punonjës	Kategoria	Paga e Grupit	Shtesa për Vjetërsi në %	Shtesa për Pozicion
1. Punonjës të sistemit me pagë grupi + shtesë pozicioni	1				
Specialist përgjegjës për ushqimin	1	III-b	1 ose 2	2%	47,000
2. Punonjës të sistemit me klasa	6	Klasa		Shtesa për Vjetërsi në %	Paga Bazë
Kuzhinier	1	VI		1%	34,500
Ndihmës Kuzhinier	4	III		1%	32,500
Shofer	1	IV		1%	33,400

Programi 09240 - Konviktet e shkollave të mesme : 4 punonjës

Emërtimi	Nr Punonjës	Kategoria	Paga e Grupit	Shtesa për Vjetërsi në %	Shtesa për Pozicion
1. Punonjës të sistemit me pagë grupi + shtesë pozicioni	0				
2. Punonjës të sistemit me klasa	4	Klasa		Shtesa për Vjetërsi në %	Paga Bazë
Kuzhinier	1	VI		1%	34,500
Ndihmës Kuzhinier	2	III		1%	32,500
Magazininier	1	V		1%	34,100

Programi 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët (ÇERDHE) : 5 punonjës

Emërtimi	Nr Punonjës	Kategoria	Paga e Grupit	Shtesa për Vjetërsi në %	Shtesa për Pozicion
1. Punonjës të sistemit me pagë grupi + shtesë pozicioni	0				
2. Punonjës të sistemit me klasa	5	Klasa		Shtesa për Vjetërsi në %	Paga Bazë
Kuzhinier	1	VI		1%	34,500
Ndihmës Kuzhinier	4	III		1%	32,500

2. Shpenzime operative (llog 602) : 57,152,319 Lekë,

Nga të cilat transfertë specifike 13,141,167 Lekë dhe të ardhura të veta (transf. e pakushtëzuar+ të ardhura vendore) 44,011,152 Lekë.

Alokimi i fondeve në këtë zë të shpenzimeve parashikohet të bëhet për :

- të mbajtur nën kontroll dhe për të ulur stokun e detyrimeve të prapambetura (sipas përcaktimeve ligjore faturat e palikujduara pas afatit mbi 60 ditë nga data e lëshimit).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Synohet që në vitin buxhetor 2021 të jenë shlyer gjithë detyrimet për shpenzime operative që datojnë nga viti 2019 deri në 31.12.2020.

- të mbështetur institucionet arsimore me materialet e nevojshme të pastrimit, dezinfektimit, si nevojë imediate në situatën aktuale të pandemisë Covid
- të rritur cilësinë e shërbimeve të funksioneve që financohen me transfertë specifike, si mirëmbajtje të objekteve shkollore, të kaldajave, të impianteve të gazit.

Shpenzimet operative në vlera si më poshtë :

- ✓ 9,747,613 Lekë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura për shpenzime operative, nga të cilat transfertë specifike 608,335 Lekë dhe të ardhura të veta (transf. e pakushtëzuar+të ardhura vendore) 9,139,278 Lekë.
- ✓ 34,444,477 Lekë , për likuidimin e faturave të muajve nëntor&dhjetor 2020 . nga të cilat transfertë specifike 372,602 Lekë dhe të ardhura të veta (transf. e pakushtëzuar+të ardhura vendore) 34,071,875 Lekë.
- ✓ 400,000 Lekë për blerjen e materialeve për dezinfektim dhe pastrim, për kopshtet , programi 9120 . Në situatën aktuale të Covid është tepër e domosdoshme të furnizohen rregullisht institucionet tona arsimore me materiale të kësaj natyre. Financimi nga të ardhurat e veta (transf. e pakushtëzuar+të ardhura vendore).
- ✓ 400,000 Lekë për blerjen e materialeve për dezinfektim dhe pastrim, për cerdhet , programi 10430. Financimi nga të ardhurat e veta (transf. e pakushtëzuar+të ardhura vendore).
- ✓ 12,160,230 Lekë, për shpenzime operative me burim të ardhurat e trashëguara nga transfertat specifike, shpenzime të cilat do të rritin cilësinë e shërbimeve në funksionet dhe programet përkatëse .

Titulli i Progr.	Emërtimi i Programit	Njësia Shpenzuese	Shp.Operative 602
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	Bashkia Berat (Aparati)	5,240,929
04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Drejtoria e Bujqësisë	2,505,509
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	Drejtoria e Bujqësisë	606,547
09230	Arsimi parauniversitar	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	220,000
09240	Konviktet e arsimit parauniversitar	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	2,180,095
10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	Qendra LIRA	1,407,150
Totali			12,160,230

3. Shpenzime kapitale llog (231): 55,566,490 Lekë

Nga të cilat transfertë specifike 32,137,621 Lekë dhe të ardhura të veta (transf. e pakushtëzuar+të ardhura vendore) 23,428,869 Lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Emërtimi i projektit	Njësia Shpenzuese	Vlera LEK
1. INVESTIME NGA TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR SEKTORIALE		32,137,621
Pajisje zyre dhe pajisje informatike per MZSH	Bashkia Berat (Aparati)	750,000
Kamioncine per transportin e druve	Drejtoria e Bujqësisë	120,000
Investime ne shkollat e mesme (hidroizolim tarace, ndertim rampa, ndertim mure rrethues, etj)	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	548,770
Investime ne konvikt (sistem ngrohes me panel diellor; ngritja e salle leximi; ndertim kend sportiv; etj.	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	29,230,851
Mjet Transporti Udhetaresh Furgon (me 18+1 vende) , Qendra LIRA	Qendra LIRA	1,488,000
2. INVESTIME NGA TE ARDHURAT E VETA (TRANSF. E PAKUSHTEZUAR + TE ARDHURA VENDORE)		23,428,869
Blerje Instrument topografik (Total Station)	Bashkia Berat (Aparati)	500,000
Supervizime e Kolaudime objekte infrastrukture	Bashkia Berat (Aparati)	1,200,000
Investime ne infrastrukturen rrugore dhe shesheve te lagjeve te qytetit	Bashkia Berat (Aparati)	19,528,869
Blerje shtreter per fjetje ne cerdhet e femijeve	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	2,200,000
TOTAL INVESTIME (1+2)		55,566,490

Sa më sipër kërkojmë të miratojmë Shtesë dhe ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 81 datë 29.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023" si më poshtë:

1. Shtesën e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2021 nga fondet e trashëguara nga viti 2020 në shumën 120,818,808 lekë në zërin : Të ardhurat e trashëguara nga viti 2020, specifikisht:

- a) Transferta specifike e trashëguar në shumën47,244,788 lekë
- b) Transferta e pakushtëzuar e trashëguar në shumën27,742,343 lekë
- c) Të ardhurat lokale të trashëguara në shumën45,831,677 lekë

2. Përdorimin e fondit prej 120,818,808 lekë si më poshtë:

- a) Transferta specifike e trashëguar në shumën 47,244,788 lekë në programet përkatëse ku ka mbetur nga viti 2020, sipas programeve :



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Alokimi i Transferts së Pakushtëzuar Sektoriale

Titulli i Progr.	Emërtimi i Programit	Njësia Shpenzuese	Totali	Paga 600	Sigurim e 601	Shp.Operati ve 602	Tot Shp. Korrente (600-602)	Shpenzime Kapitale 231
03280	Mbrojtja nga zjari dhe mbrojtja civile	Bashkia Berat (Aparati)	6,151,961	0	0	5,401,961	5,401,961	750,000
04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujërës dhe kullimit	Drejtoria e Bujqësisë	2,505,509	0	0	2,505,509	2,505,509	0
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	Drejtoria e Bujqësisë	726,547	0	0	606,547	606,547	120,000
09230	Arsimi parauniversitar	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	768,770	0	0	220,000	220,000	548,770
09240	Konviktet e arsimit parauniversitar	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	34,196,851	1,687,000	279,000	3,000,000	4,966,000	29,230,851
10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	Qendra LIRA	2,895,150	0	0	1,407,150	1,407,150	1,488,000
Totali			47,244,788	1,687,000	279,000	13,141,167	15,107,167	32,137,621

b) Shuma 73,574,020 lekë nga fondet e veta (transfertë e pakushtëzuar + të ardhura të trashëguara) të shpërndahet sipas tabelës më poshtë:

Alokimi i Të Ardhurave të veta (Transf. e Pakushtëzuar e Përgjithshme + Të Ardhurat Vendore)

Titulli i Progr.	Emërtimi i Programit	Njësia Shpenzuese	Totali	Paga 600	Sigurime 601	Shp.Operative 602	Tot Shp. Korrente	Shpenzime Kapitale 231
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	Bashkia Berat (Aparati)	1,072,949	0	0	572,949	572,949	500,000
04520	Rrjeti rrugor rural	Bashkia Berat (Aparati)	30,172,964	0	0	9,444,095	9,444,095	20,728,869
04520	Rrjeti rrugor rural	Bashkia Berat (Aparati)	20,728,869	0	0	0	0	20,728,869
04520	Rrjeti rrugor rural	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	9,444,095	0	0	9,444,095	9,444,095	0
05100	Menaxhimi i mbetjeve	Bashkia Berat (Aparati)	27,188,802	0	0	27,188,802	27,188,802	0
06260	Shërbimet publike vendore	Bashkia Berat (Aparati)	385,186	0	0	385,186	385,186	0
06440	Ndricimi Publik	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	1,800,000	0	0	1,800,000	1,800,000	0
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	6,738,670	3,186,000	527,000	3,025,670	6,738,670	0
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	6,215,449	2,077,000	344,000	1,594,449	4,015,449	2,200,000
Totali			73,574,020	5,263,000	871,000	44,011,151	50,145,151	23,428,869

3. Ndryshime në programet përkatëse, në pasqyrën “ Detajimi i buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2021 sipas programeve”, si më poshtë:

Shtesa:

Programi	Peërshkrim programi	Artikulli	Shuma LEK
04520	Investime në infrastrukturën rrugore	231	2,722,188
	Shuma e shtesave		2,722,188



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Pakësime :

Programi	Përshkrim programi	Artikulli	Shuma LEK
10430	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	231	1,488,000
09240	Konviktet e arsimit parauniversitar	602	1,234,188
	Shuma e pakësimeve		2,722,188

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin ,

DREJTORI I MENAXHIMIT FINANCIAR DHE TË ARDHURAVE

Rovena Shehu